



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr. 763/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Zyhdi Haziri anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtarit Ligjorë Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me apelin e parashtruar nga Arif Miftari, kandidat për anëtar të Kuvendin Komunal në Lipjan, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Lipjan, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si i pabazuar apeli i parashtruar nga Arif Miftari, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Lipjan, me shenjën ZL.Anr.763/2017, të datës 09.11.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve(KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datë 09.11.2017, nga Arif Miftari, kandidat për anëtar të Kuvendin Komunal në Lipjan, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Lipjan, në të cilën pretendon se pas publikimit të rezultateve nga KQZ-ja rezulton se në vendvotimin VV nr. 1322E/02R nuk janë regjistruar 16 vota dhe figurojnë 0 vota, ndërkaq në FRK janë të shënuara votat e tij, të njëjtat figurojnë 16 vota, duke theksuar se votat nga diaspora që i mungojnë janë 2, ndërsa votat me kusht i ka 4.

Në cilësi të provës apelit i ka bashkangjitur një deklaratë dhe Formularin e Rezultateve për Kandidatë.

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë së apelit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli vlerëson se apeli i apeluesit është i pabazuar dhe si të tillë e refuzoj për faktin se apeluesi në apel nuk e ka potencuar se sa vota i mungojnë në vendvotimin VV nr. 1322E/02, dhe në mbështetje të pretendimeve ankimore në apel nuk ka ofruar asnjë dëshmi bindëse për të vërtetuar bazueshmerin e apelit, në kuptim të nenit 117 par. 3 të LZP-së, ku është përcaktuar: *“se vendosja për ankesa dhe apele nga PZAP-i mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*. Paneli gjatë vendosjes për një apel i shqyrton dhe i heton me kujdes të gjitha provat e bashkangjitura në apel dhe kur vlerëson se pretendimet në apel nuk janë të provuara me prova nga parashtruesi i apelit, andaj apelin e refuzoj si të pa bazuar.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë duke u bazuar në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)

Anr.763/2017 më datën 12.11.2017.



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*